ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapsinor dhe Infrastrukturës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **210-23-7815-2-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Angazhimi i një OE, për PR-Public Relation për MMPHI**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Moviola L.L.C dhe platforma Advertising L.L.C

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Isa Kastrati dhe Muharrem Fejza OB Kawa Group HY-A, 6-1

(Adresa)

Prishtinë *10000*

(Vendi) *(Kodi postar)*

+38345312885 *n/a*

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Vesa Broqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Broqivesa@gmail.com

(Adresa elektronike)

20.09.2023

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

LIMITED LIABILITY COMPANY MOVIOLA L.L.C. PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi per anulim te aktivitetit *te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Data e njoftimit per kontrate:27.07.2023

Data e Njoftimit mbi Vendimin e AK : 04.09.2023

Letra standrde per tenderuesin e eliminuar:04.09.2023

Procesverbali i hapjes: 17.08.2023 ora: 13:00

Kërkesa për rishqyrtim: 08.09.2023

Vendimi për pezullim: 08.09.2023

Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim datë:11.09.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒ x

Procesverbalin e hapjes e kemi pranuar permes E - prokurimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Ne si OE kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues konfrom nenit 108 A të LPP-së.

Shkeljet e Autoriteti Kontraktues (Ministria e Mjedisit, Planifikimi Hapësinor dhe Infrastruktur) ndaj neve si OE, janë evidente dhe te faktuara me dëshmi të cilat kompromitojnë këtë proces të prokurimit nga shkeljet e LPP-së në mënyrë të hapur dhe të drejtëpërdrejtë.

Autoriteti Kontraktues i mohon të gjitha faktet e ofruara gjatë procesit të zhvillimit të proceurës së prokurimit dhe mbulon papërgjegjshmërinë me shkeljet të cilat janë të evidente.

Në vazhdim do ti paraqesim edhe dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Referuar LPP dhe Rregullores nr. 001/2023 per prokurim publik, Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit,

Neni 4.4.1

c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut

4.3 Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive

b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paranë për Autoritetin Kontraktues.

c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.

Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve

45.17 Si një masë paraprake, autoriteti kontraktues duhet të kontrollojë se tenderët janë në përputhje me kërkesat formale të dosjes së tenderit, me fjalë të tjera përgjegjshmëria në një kuptim formal. Një tender konsiderohet të jetë formalisht i përgjegjshëm, në qoftë se përmbush të gjitha kërkesat formale në dosjen e tenderit, pa devijuar substancialisht nga apo pa i bashkangjitur atyre kufizime.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Shkelja e dispozitës referuar LPP dhe Rregullores nr. 001/2023 per prokurim publik, Neni 4. Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit,

pika.c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut, dhe nenit,

4.3 Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.

a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive

Sqarim:

Ne si OE kemi dorëzuar ofertën pranë Autoritetit Kontraktues duke plotësuar kriterin bazë të procedurës, **oferta e përgjegjshme me çmimin me te lirë**, duke ofruar ofertën në vlerë prej: **67, 968.00 €,** ndërsa çmimi i ofertës të OE, të shpallur fitues është: **85, 940.00 €,** me një ndryshim më **të lartë se sa oferta jonë** në vlerë prej: **17, 972.00 € .**

AK, siç mund të shihet në arsyet e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim ka dhënë arsye ku me vetëdije të plotë deklaron se çmimi i ofertës fituese është **brenda vlerës së parashikuar të kontratës**, duke mos marrë për bazë se oferta jonë **është më e lirë prej 17, 972.00 € se oferta fituese,** duke shkelur kriterin kryesor të procedurës, kriterin: **" oferta e përgjegjëshme me çmimin më të lirë "** të njëjtën kohë ofertën tonë e kanë vlerësuar si të papërgjegjshme, pa asnjë argument, vetëm duke krijuar arsye fiktive, ku për këtë do të ju oforjmë dëshmi të mjaftueshme të cilat argumentojnë shkeljet e AK, të LPP dhe Rregullores për Porokurim Publik, në nenet përkatëse.

Lidhur me kërkesën për certifikatën e biznesit, kërkesa si në vazhdim:

1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit .	1. Çertifikata e regjistrimit tw biznesit - kopje .

AK, për të njëjten kërkesë ka kërkuar sqarim shtesë dhe pas kërkesës për sqarim ne i kemi ofruar dokumentet me ndryshimet e fundit (dokumente këto të leshuara nga ARBK në bazë të kërkesës së bërë nga AK) e cila vërteton se statusi është i regjistruar. Ne e kemi dorëzuar sqarimin sipas kërkesës të AK, me datë: ***24.08.2023****. Përkundër ofrimit të sqarimeve, AK nuk i ka marrë për bazë dhe si arsyetim të eleminimit ka ofruar një 'screenshot' nga web-faqja e ARBK-së ku biznesi jonë figuronte si "pasiv" gjë e cila është e pakuptueshme sepse ne kemi marr dokumenta nga ARBK të lëshuara me datë* ***24.08.2023*** *dhe në asnjë moment nuk na është tërhequr vëmendja se biznesi jonë figuron si "pasiv". Vlen të ceket se në kërkesën për sqarim nuk është përmendur asnjeherë çështja e statusit dhe si të tillë ne nuk kemi pasur pasqyrë të plotë të kësaj kërkese specifike. Për më tepër, edhe gjatë procesit të tenderimit dhe ofertimit, ne kemi ofruar dëshmi të mjaftueshme rrethanore se kemi qenë*

biznes aktiv përmes qarkullimit bankar në 3 vitet e fundit(sipas kërkesës në tender), jemi tatim pagues të rregullt, deklarues të TVSH si dhe vërtetim nga Gjykata relevante se nuk kemi qenë në proces falimentimi. Të gjitha këto dëshmojnë qe kompania jonë ka operuar në mënyrë aktive nga themelimi i saj.

Pas njoftimit për vendim të eliminimit të kompanisë tonë nga AK me arsyetimin e lartëcekur, ne kemi hyrë në web-faqen e ARBK dhe nuk na ka dal pretendimi i AK se biznesi jonë është 'pasiv' por ka dal " i regjistruar". Kështuqë, përshkakë se për neve është e tejet e paqartë se si ka mundësi të figuroj biznesi "pasiv" për AK, kemi kërkuar vërtetim dhe konfirmim nga Institucioni Zyrtar ARBK i cili e ka lëshuar dokumentin (certifikatën e biznesit) dhe i njëjti ka vërtetuar se statusi i çertifikatës tonë të biznesit është status " i regjistruar " dhe jo status " pasiv " siç e ka arsyetuar AK në eliminimin e ofertës tonë.

Dëshmi:

Konfirmimin (dëshminë) për këtë, nga ARBK e gjeni të bashkangjitur me Ankesë.

Shkelja e dispozitës, Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve

45.17 Si një masë paraprake, autoriteti kontraktues duhet të kontrollojë se tenderët janë në përputhje me kërkesat formale të dosjes së tenderit, me fjalë të tjera përgjegjshmëria në një kuptim formal. Një tender konsiderohet të jetë formalisht i përgjegjshëm, në qoftë se përmbush të gjitha kërkesat formale në dosjen e tenderit, pa devijuar substancialisht nga apo pa i bashkangjitur atyre kufizime.

Sqarim:1

AK, e ka vlerësuar si të papërgjegjëshme dëshminë për kërkesën: Deklarata nën Betim, duke ofruar sqarim se deklaratën nën betim nuk e kemi plotësuar sipas aneksit 2 të dosjes së tenderit.

Lidhur me kërkesën/dëshminë, Deklarta nën Betim konsiderojm se i përmbanë të gjitha kushtet për të qenë e përgjegjëshme, referuar dëshmive dhe argumenteve si në vazhdim.

Referuar dosjes së tenderit dhe pjesës udhëzuese për plotësimin e kërkesës, Deklarata nën Betim

Dosja e tenderit, Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik neni 6.4, ***Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.***

Siq mund të shihet ne si Operator ekonomik konkurues të përgjegjshëm me çmimin më të ulët e kemi ofruar/plotësuar deklaratën nën betim sipas nenit 6.4. të përcaktuar dhe kërkesës së dosjes së tenderit sipas aneksit 2.

Dëshmi:

Me ankesë do të bashkangjesim deklaratën nën betim të dorëzuar me ofertë.

Sqarim 2:

Po ashtu lidhur me plotësimin e deklaratës nën betim e gjeni të bashkangjitur edhe interpretimin nga KRPP

A duhet kërkuar sqarime shtesë në bazë të nenit 72 të LPP-ës, në rast se Operatorët Ekonomik nuk e dorëzojnë bashkë me ofertat e tyre "Deklaratën nën betim" ?

"Deklarata nën betim" është kusht administrativ dhe dëshmi që kërkohet sipas nenit 65 të LPP-së për të dëshmuar përshtatshmërinë e OE-së për pjesëmarrje në aktivitetin aktual të prokurimit (pra që është në fazën e tenderimit) dhe si e tillë ajo nuk mund të kërkohet në bazë të nenit 72 të LPP-ës, ngase ekzistenca e saj (pra e deklaratës nën betim) nuk mund të verifikohet në mënyrë objektive nga AK siç e kërkon paragrafi 3 i nenit 72 të LPP-ës.
Pra me një fjalë, deklarata nën betim nuk është një dokument i cili e plotëson kërkesën e paragrafit 3 të nenit 72 të LPP-ës, për këtë arsye, Deklarata nën betim, duhet të nënshkruhet vuloset.

VENDIM

- ***Kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik të anuloj njoftimin mbi Vendimin e AK.***
- ***Ti merrë për bazë dëshmitë dhe argumentet e paraqitura.***
- ***Lëndën të kthejë në favor tonin dhe AK ofet ren tone ta trajtoj si të përgjegjëshme.***

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Vlera e cila pritet te shkaktohet nga shkelejt e supozuara eshte 65,000.00 €

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*
h) *Vertetimin për certifikatën e biznesit nga ARBK*
i) *Interpretimin e KRPP-së për plotësimin e Deklaratës nën Betim*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*